



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno / Predato Received / Delivered	31.12.2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Pr. Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHACK	6485/2021		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.955/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi -anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke u bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.3092/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative të datës 22.11.2021, e pranuar në Këshill me datë 24.11.2021, ka rishqyrtuar ankesën e ankueses me numër A.nr.673/2018 të datës 18.10.2018, në çështjen juridike “kompensim material”, kundër organit të punësimit Komuna e Laposaviqit, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 31.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. SHFUQIZOHET Vendimi me numër 136/1 i datës 17.09.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Laposaviqit.
- II. OBLIGOHET Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Laposaviqit që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale ligjore për ta rishqyrtuar lëndën e ankueses
- III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Laposaviqit, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit të përcaktuar nën pikën II të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 28.02.2012 dhe të datës 01.07.2016 në pozitën “Zyrtare për Shërbime Sociale” në Komunën e Laposaviqit, nga muaji mars 2018 nuk i është proceduar paga në xhirollogarinë e saj për punën e saj pa ndonjë vendim të institucionit apo arsyetim.

Ankuesja me datë 13.04.2018 i është drejtuar Drejtorisë së Financave me kërkesë, mirëpo nuk ka marr përgjigje dhe pas kësaj më datë 10.05.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Leposaviqit edhe për kundër obligimit ligjor të paraparë më dispozitat ligjore në fuqi nuk ka shqyrtuar ankesën e ankueses.

Ankuesja, kundër heshtjes administrative të Komunës së Leposaviqit, më datë 07.06.2018, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3190/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, me datë 05.09.2018 ka marrë vendimin me numër A.nr.344/2018 me të cilin vendim ka detyruar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të bëjë shqyrtimin e ankesës së datës 07.06.2018 të parashtruar nga ankuesja

Ankuesja me datë 18.10.2018 ka parashtruar kërkesën me numër të protokollit 6162/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me të cilën e ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës se nuk është zbatuar vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe ka kërkuar nga Këshilli që të ndërmerren masat në pajtim me Ligjin, që këto konteste të zgjidhen në afat sa më të shkurtë. Po ashtu organi i punësimit me date 18.10.2018 ka njoftuar Këshillin se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Leposaviqit, me datë 17.09.2018 ka nxjerr vendim me numër 136/1 me të cilin vendim e ka refuzuar ankesën e ankueses si e pa bazuar, duke e zbatuar vendimin me numër A.nr.344/2018 të datës 07.06.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Këshilli pas njoftimit të ankueses Mirjana Duricic dhe në bazë të kërkesës së saj e ka aktivizuar lëndën me numër A.nr.344/2018 të datës 07.06.2018 dhe me datën 03.12.2018 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.673/2018, me të cilin vendim e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses të parashtruar me datë 07.06.2018.

Ankuesja e pakënaqur Vendimin me numër A.nr.673/2018 të datës 03.12.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 31.12.2018 parashtron padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 22.11.2021 merr Aktgjykim me numër A.nr.3092/18 të cilin Aktgjykim e aprovon kërkesë padinë e paditëses dhe e anulon vendimin e Këshillit me numër A.nr.673/2018 të datës 03.12.2018 dhe çështjen e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje. Aktgjykim me numër A.nr.3092/18 të datës 22.11.2021, Këshilli e ka pranuar me datë 24.11.2021 me numër të protokollit 3092/18.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: E-mail i datës 27.11.2018; Konkursi i datës 02.06.2017; Vendimi i datës 03.07.2017; Kandidatët e pranuar sipas konkursit të ri në Korrik të vitit 2017; Lista për pagesën e pagave në Qendrën për Punë Sociale të datës 14 tetor 2017; Lista për pagesën e pagave në Qendrën për Punë

Sociale të datës 14 tetor 2018; E-mail i datës 30.11.2018; Dërgimi i të dhënave lidhur me shkresën e juaj të datës 29.11.2018 nga Komuna e Leposaviqit me numër SI datë 29.11.2018; Lista e pagave prill 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave gushtë 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave shkurt 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave janar 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave qershor 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave maj 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave mars 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave nëntor 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave shtator 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave korrik 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave tetor 2018 nga Republika e Serbisë; Kërkesa e ankuesit e datës 18.10.2018 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në kërkesë e datës 18.10.2018 nga Komuna e Leposaviqit; Aktvendimi i datës 17.09.2018 me numër 136/1 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit; Vendimi me numër 15/52 i datës 22.06.2018 i Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Ankesa e ankuesit e datës 07.06.2018 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Letër njoftimi i ankueses Akt Emërimit e datës 28.02.2012 dhe 01.07.2016; Marrëveshjen e Mirëkuptimit me Nr. 178 të datës 03.06.2016; Vendimi i datës 02.08.2018 për vazhdimin e afatit për vendosjen e ankesës; Planifikimi i buxhetit për financimin e pagave dhe shpenzimeve tjera operative për QPS Leposaviq; Lista e Punëtorëve të Qendrës për Punë Sociale në Leposaviq datë 25.05.2016; Automjetet e QPS-ve datës 24.05.2016; Kërkesën e datës 13.04.2018 e ankueses për Drejtorinë e Financave; Ankesën e datës 07.05.2018 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit; Gjendja e Llogarisë bankare prej 31.01.2017 deri më datë 04.06.2018; Procesverbal i Komisionit Mjekësor për vlerësimin e paaftësisë së kufizuar të përhershme i datë 22.03.2018; Regjistri i aplikacioneve për ndihmë sociale dhe Komisioni mjekësor për 03/2018, 04.2018 dhe Kërkesën për përgjigje e datës 13.06.2018 me numër protokolli 3335/2018; Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.344/2018 i datës 05.09.2018; Kërkesa për largimin nga lista e pagave e datës 17.01.2018 nga Kryetari i Komunës së Leposaviqit për MAPL; Kërkesë për dhënien e pëlqimit për largimin nga lista e pagave e datës 11.06.2018 nga Kryetari i Komunës së Leposaviqit; Kërkesa për largimin nga lista e pagave e datës 16.08.2018 nga Kryetari i Komunës së Leposaviqit; Kërkesë për largimin nga lista e pagave e datës 15.08.2018 nga Kryetari i Komunës së Leposaviqit; Vendimi i datës 03.08.2018 me numër 710 i Kryetarit të Komunës së Leposaviqit; Raporti i Komisionit i datës 10.07.2018; Tabela e punëtorëve të cilët fshihen nga lista e pagave për shkak të anulimit të konkursit në bazë të cilit janë pranuar në marrëdhënie pune; Aktvendimi për formimin e Komisionit për rishqyrtimin e ligjshmërisë së konkursit të shpallur me datë 02.06.2017; Kërkesë për respektimin e procedurave për shpalljen e konkursit në Komunën e Leposaviqit të datës 08.12.2016 nga Ministri i MAPL; Njoftim i datës 15.09.2015, kërkesa për pranimin e punëtorëve e datës 19.07.2017 si dhe Aktgjykimi me numër A.nr.3092/18 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke vepruar sipas Aktgjykimit me numër A.nr.3092/18 të datës 22.11.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka marrë në rishqyrtim lëndën e ankueses

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin numër A.nr.3092/18 të

datës 22.11.2021, e ka aprovuar kërkesë padinë e paditëses Mirjana Duricic si të bazuar dhe e ka anuluar Vendimin me numër A.nr.673/2018 të datës 03.12.2018 të nxjerr nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshill.

Me këtë Aktgjykim, Gjykata duke u bazuar në shkresat e bashkangjitura të lëndës ka vërtetuar se ankuesja e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 28.02.2012 dhe akt emërimit të datës 01.07.2016 me numër 03/2016 në vendin e punës "Zyrtar për Shërbime Sociale" në Qendrën për Punë Sociale në Komunën e Leposaviqit, nga muaji mars 2018 nuk i është procesuar rroga ne xhirologarinë e saj me arsyetim se e njëjta paguhet edhe nga buxheti i Republikës së Serbisë. Po ashtu Gjykata ka konstatuar se me rastin e vendosjes lidhur me ankesën e ankueses dhe pretendimeve ankimore të ankueses si nga organi i punësimit dhe pala e paditur gjegjësisht në vendimet e tyre kontestuese nuk është vërtetuar sakte respektivisht nuk ka ndonjë arsyetim konkret si dhe nuk përmendet asnjë prove e shqyrtuar në baze të së cilave janë konstatuar faktet vendimtare apo mbi cilat dispozita ligjore janë mbështetur vendimet kontestuese, më tutje Gjykata ka gjetur se ekziston edhe mospërputhje midis provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe konstatimet e dhëna në arsyetimin e vendimeve respektivisht Gjykata ka konstatuar nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike gjegjësisht se si është vërtetuar fakti se paditësja në të njëjtën kohë ka realizuar dy paga nga dy shtete të ndryshme kur organi i punësimit dhe pala e paditur edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk kanë ofruar dëshmi apo prova me të cilin do ta vërtetonin gjendjen e përshkruar në vendimet e tyre të kontestuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke marr parasysh konstatimet dhe të gjeturat e Gjykatës, se organi i punësimit dhe pala e paditur nuk kanë ofruar dëshmi apo prova me të cilat do ta vërtetonin se si paditësja në të njëjtën kohë ka realizuar dy paga nga dy shtete të ndryshme, si dhe duke marr parasysh edhe praktikën e vendimmarrjes në Këshill në raste të tilla, ka konstatuar se ekziston baza ligjore për të vendosur që lënda të kthehet në rishqyrtim duke e obliguar Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rishqyrtimin e ankesës së datës 07.05.2018 të parashtruar nga ankuesja, për të konstatuar dhe vërtetuar saktë me prova dhe fakte nëse ankuesja ka realizuar në të njëjtën kohe dy paga mujore nga dy shtete të ndryshme në kundërshtim me legjislacionin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.


Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Leposaviqit, është i obliguar që me rastin e rishqyrtimit të ankesës së ankueses, të shqyrtoj të gjitha pretendimet ankimore të ankueses dhe posaçërisht të vërtetoj gjendjen faktike me prova konkrete se si ankuesja ka realizuar paga mujore nga dy burime gjegjësisht nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga Republika e Serbisë/Ministria e Punës, Punësimit dhe Çështjeve Sociale, andaj Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me rastin e rishqyrtimit duhet të ketë parasysh faktin se duhet të vërtetoj saktë se në cilën periudhë kohore ankuesja ka realizuar dy paga nga dy shtete të ndryshme, e jo të jap vetëm formulim të përgjithshëm të rastit po në bazë provave dhe fakteve të vendosë meritorisht për lëndën e ankueses dhe të zbatoj legjislacionin e aplikueshëm për atë periudhë kohore, duke marr parasysh konstatimet dhe të gjeturat me Aktgjykimin me numër A.Nr. 3092/18 të datës 22.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative

gjithnjë duke marr parasysh dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dispozitat e Rregullores Nr. 05/2010 për Procedurat e për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave si dhe konstatimet e dhëna në këtë vendim.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas Aktgjykimit me numër A.Nr. 3092/18 të datës 22.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative , vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.955/2021

Valentina Kaçandolli Bekteshi



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Gjyqtare: Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative;
- Kryetarit të Komunës së Leposaviqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Leposaviqit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

